



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 170 Datë 18.12.2012*

**PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË SHITJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE MES KESH SH.A DHE ENERGJI ASHTA SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 8.1.1 të Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë Elektrike mes Energji Ashta sh.p.k dhe KESH sh.a, miratuar me VKM nr.1363, datë 17.10.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k,

**Vendosi:**

1. Të miratoje Marrëveshjen e shitjes së energjise elektrike mes KESH sh.a dhe Energji Ashta sh.p.k, miratuar me VKM nr. 1363, datë 17.10.2008. (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë shoqëritë e interesuara për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**